

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E martë, 19 gusht 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes

6 videolidhjes]

7 --- Seanca fillon në orën 10.01

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,

9 të gjithëve.

10 Z. Sekretar i seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

11 SEKRETAR I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

12 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i

13 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

14 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej, për

16 procesverbal, se z. Krasniqi na ndjek sot përmes videolidhjes.

17 Ndërkohë që të akuzuarit e tjerë janë të pranishëm në sallën e

18 gjyqit. Po ashtu vërej se znj. Alagendra na ndjek përmes

19 videolidhjes. Mirëmëngjes, znj. Alagendra.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përmes videolidhjes] [Mikrofoni

21 çaktivizuar].

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot ne do të

23 mbajmë konferencën për përgatitjen e Mbrojtjes që vijon, që

24 paraprin hapjen e provave të Mbrojtjes sipas rregullës 119.

25 Përpara sesa të fillojmë, rikujtoj që Prokuroria ka hapur

1 çështjen e saj më 3 prill 2023 dhe ka paraqitur dëshmitarët e
2 saj në periudhën e kohës nga 11 prilli 2023 deri më 27 mars
3 2025. Prokuroria përfundoi me mbylljen e paraqitjes së provave
4 të saj më 15 prill të këtij viti. Ndërkohë që më 16 korrik
5 2025, Trupi Gjykses vendosi që të mos e mbyllë çështjen në
6 pajtim me rregullin 130.

7 Në pajtim me rregullin 119(1), Mbrojtja e z. Thaçi dhe z.
8 Krasniqi përkatësisht e informuan Trupin Gjykses më 16 korrik
9 2025 që synojnë që të paraqesin provat e tyre.

10 Më 25 korrik 2025, Trupi Gjykses urdhëroi mbajtjen e
11 konferencës për përgatitjen e Mbrojtjes sot. Qëllimi i kësaj
12 konference është që të përgatitemi për paraqitjen e provave të
13 Mbrojtjes dhe për të siguruar që nuk do të shkaktohen vonesa
14 të papërligjura për sa i takon përmbushjes dhe përfundimit të
15 kësaj çështjeje gjyqësore. Tani do të kalojmë disa pika që
16 Trupi Gjykses dëshiron që t'i ngrejë në përputhje me rregullin
17 119 dhe çështje të tjera të cilat janë pezull. Pas saj, të
18 gjithë palët kanë mundësinë që të ngrenë çështje dhe aspekte
19 të cilat i konsiderojnë të domosdoshme për të diskutuar sot.

20 Përpara sesa të fillojmë me thelbin e Konferencës për
21 Përgatitjen e Mbrojtjes, Trupi Gjykses dëshiron që të lëshojë
22 një urdhër gojor.

23 Trupi Gjykses rikujton që më 13 maj 2025, Trupi Gjykses
24 lëshoi vendime mbi kërkesat e z. Veseli, Selimi dhe Krasniqi
25 për lirim të përkohshëm dhe në lidhje me z. Selimi dhe z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 Krasniqi rishikimin periodik të përdymuajshëm të mbajtjes në
2 ndalim. Të tre ekipet e Mbrojtjes i apelian vendimet
3 përkatëse. Përveç kësaj, të akuzuarit hoqën dorë nga të
4 drejtat e tyre për rishikim periodik të paraburgimit të tyre
5 derisa të merrej vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.

6 Më 14 gusht 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi tri
7 vendime për apelet e të akuzuarve. Për rrjedhojë, rishikimi
8 periodik i paraburgimit të akuzuarve do të vazhdojë dhe Trupi
9 Gjykues do të përcaktojë një kalendar për parashtrimet për
10 palët.

11 Trupi Gjykues vëren se, në parashtrimet F03273, F03274,
12 ZPS-ja ka dorëzuar parashtrime që kanë të bëjnë me rishikimin
13 periodik për paraburgimin e z. Krasniqi dhe z. Selimi. ZPS-ja
14 nuk ka bërë parashtrime lidhur me rishikimin periodik të
15 paraburgimit të z. Veseli.

16 Për të lejuar ZPS-në për të pasur mundësinë që të
17 shqyrtojë dhe të bëjë parashtrime sa i takon konstatimeve të
18 Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me tre të akuzuarit,
19 Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në të dorëzojë parashtrime që kanë
20 të bëjnë me rishikimin periodik të burgimit të z. Veseli dhe
21 parashtrime shtesë që kanë të bëjnë me rishikimin periodik të
22 paraburgimit të z. Krasniqi, z. Selimi deri të martën, më
23 datën 26 gusht 2025, si dhe urdhëron që të jepen përgjigjet
24 dhe kundërpërgjigjet përkatëse në afatet kohore të përcaktuara
25 në rregullin 76.

1 Kjo përfundon urdhrin me gojë të Trupit Gjykues numër I.

2 Ndërkohë, më 1 gusht 2025, Mbrojtja e z. Thaçi dorëzoi
3 parashtimin F03381, një kërkesë për Trupin Gjykues për të
4 urdhëruar Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve
5 që të marrë masa të caktuara në lidhje me një dëshmitar. ZPS-
6 ja dhe Mbrojtësi i Viktimave i janë përgjigjur kësaj kërkesë.
7 Mbrojtja e Thaçit është kundërpërgjigjur.

8 Që prej kërkesës që i është bërë Zyrës për Mbrojtjen dhe
9 Mbështetjen e Dëshmitarëve për marrjen e masave të caktuara,
10 Trupi Gjykues dëshiron që të ftojë parashtime nga Zyra
11 Administrative mbi këtë çështje deri të martën, 26 gusht 2025.

12 Ky është fundi i urdhrit të dytë me gojë.

13 Më 21 korrik 2025, Mbrojtja e z. Thaçi dhe z. Krasniqi
14 dorëzuan listën e dëshmitarëve dhe provave materiale në pajtim
15 me rregullën 119(2). Sa i takon listës së provave materiale,
16 Trupi Gjykues vëren se në përputhje me urdhrin e Trupit
17 Gjykues në F03371, ekipet e Krasniqit dhe të Thaçit kanë
18 dorëzuar versione të rishikuara të listave të provave
19 materiale në mënyrë të tillë që të përfshijnë vetëm provat
20 materiale të propozuara që synon që të paraqesin në gjykim.

21 Ndërkohë që Trupi Gjykues ka disa pyetje që kanë të bëjnë
22 me autorizimin dhe përkthimet përkatëse sipas rregullës 107,
23 të cilat do të diskutohen sot më vonë, Trupi Gjykues dëshiron
24 që shkurtimisht të dëgjojë palët lidhur me listat e provave
25 materiale të cilat pretendohet që të jenë në përputhje me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 5

1 rregullën 119(2) dhe në qoftë se kanë çështje të tjera pezull
2 sa i takon kësaj.

3 Së pari Mbrojtja e z. Thaçi.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Së pari, nuk e kam të qartë çfarë
5 doni të thoni autorizim sipas rregullës 119?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
7 ndizni mikrofonin.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndoshta është mirë që të vendosni
9 kufjet.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Njëri prej
11 nesh duhet ta ketë gabim.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Zakonisht jam unë personi që e ka
13 gabim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
15 mund të vazhdoni.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e kam të qartë për çfarë e
17 keni fjalën kur thoni për dispozitën sipas rregullës 119(2).
18 Mund të na e sqaroni? E keni fjalën rregullën 119(2)(b), apo
19 jo?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtu kam
21 shkruar vetëm 119(2), (b) mund të jetë e saktë si version.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Të gjitha provat që janë listuar
23 në listën e provave materiale do të përdoren përpara Trupit
24 Gjykues.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asnjë konstatim tjetër
2 shtesë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
4 Alagenda?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] E kuptojmë. Me sa e kuptojmë neve,
6 ne i kemi përmbushur të gjitha detyrimet.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon
8 listës së dëshmitarëve, më 5 dhe 7 gusht 2025, Mbrojtja e
9 Thaçit ka nxjerrë identitetin dhe informacionin që kërkohet në
10 përputhje me rregullën 119(2) për tre dëshmitarë shtesë të
11 Mbrojtjes. Trupi Gjykses kupton që përmbledhjet e pesë
12 dëshmitarëve që Mbrojtja e Thaçit synon që të thërrasë mbeten
13 ende pezull.

14 Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit ka
15 nxjerrë një deklaratë në versionin fillestar të saj të këtyre
16 dëshmitarëve në paketën e materialeve të nxjerra me numër
17 1751. Trupi Gjykses për pasojë dëshiron që të konfirmojë që
18 Mbrojtja e z. Thaçi do të vazhdojë të përdorë këto materiale
19 dhe që do të vazhdojë që të nxjerrë përmbledhjet që mbeten.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Për të qenë të qartë, deri tani ne
21 kemi nxjerrë të gjitha identitetet e të gjithë dëshmitarëve.
22 Kemi nxjerrë gjithashtu edhe deklaratat për shtatë dëshmitarë.
23 Një prej dëshmitarëve që e kemi bërë të njohur do të ketë një
24 përmbledhje që do ta nxjerrim më vonë, megjithatë na duhet që
25 të marrim autorizimin, që presim që ta marrim nga Mbretëria e

1 Bashkuar gjatë kësaj jave, pas kësaj do japim përmbledhjen e
2 këtij e dëshmitari, do t'ia bëjmë me dije Trupit Gjykues.

3 Kemi katër dëshmitarë për të cilët ne kemi nxjerrë
4 identitetin e tyre, por ndërkohë për ta nuk kemi dhënë
5 përmbledhje ose deklarata të tyre. Këto janë 1DW007, 1DW008,
6 1DW009.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
8 jepni një datë kur mund të na i dorëzoni këto dokumente?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni një çast, do t'i jap
10 fjalën kolegut tim nëse mundem?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

12 Z. PROSPER: [Përkthim] Mirëmëngjes. Së pari, më lejoni të
13 them që është kënaqësi që të jem i pranishëm në këtë sallë
14 gjyqi dhe përpara këtij Trupi Gjykues. Është hera ime e parë
15 që jam në sallën e gjyqit.

16 Përgjigja për këtë pyetje është që ne nuk e dimë.
17 Kërkesat kanë kohë që i janë dërguar ofruesve të informacionit
18 dhe në rastin në fjalë bëhet fjalë për Shtetet e Bashkuara,
19 për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Kemi pasur komunikim të
20 vazhdueshëm me ta dhe na kanë thënë vazhdimisht që po e
21 trajtojmë kërkesën.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A janë të
23 informuar ata që seancat, provat e Mbrojtjes do të fillojnë së
24 shpejti?

25 Z. PROSPER: [Përkthim] Po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po mbase
2 duhen informuar më mirë, se mbase mund t'i japin lejen dhe
3 autorizimet e tyre kur të jetë shumë vonë?

4 Z. PROSPER: [Përkthim] Janë shumë të informuar, janë
5 shumë mirë të informuar. Dhe sa i takon procesverbalit dhe
6 disa sqarimeve dhe çështjes së pranueshmërisë së këtyre
7 dëshmitarëve kur kjo çështje të ngrihet, pra, sikurse mund ta
8 vëreni, ne kemi një listë të gjerë dëshmitarësh. Pra, unë nuk
9 mund t'i them këto emra në publik, megjithatë bëhet fjalë për
10 persona me një staturë të madhe, domethënë, persona të cilët
11 janë shumë të njohur si, për shembull, Sekretarja Albright,
12 Richard Holbrooke, Senatori Doll, e të tjerë.

13 Informacioni që ne kemi është informacion shfajësues,
14 kështu që për këtë arsye është shumë e rëndësishme për ne për
15 ta vendosur në kontekst këtë. Domethënë, është material, është
16 informacion shfajësues. Dhe kemi të bëjmë me informacion që
17 lidhet drejtpërdrejt me lëndën e Prokurorisë dhe teorisë ose
18 tezës së Prokurorisë. Sikurse e dimë, në juridiksione të tilla
19 si gjermania, Shtetet e Bashkuara dhe Zvicër, informacioni
20 shfajësues merr një peshë shumë të madhe, peshë aq shumë të
21 madhe sa është gjykatësi që ka detyrën që të hetojë në lidhje
22 me këtë informacionin shfajësues me të njëjtën rëndësi.
23 Sikurse e dimë ne, në Shtetet e Bashkuara, në qoftë se nuk
24 prezantohet informacioni shfajësues, ky mund të jetë një gabim
25 i madh. Në Tribunalin e ish-Jugosllavisë, informacioni

1 shfajësues është i pranueshëm deri në momentin e aktgjykimit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk po ju
3 them se nuk mund ta paraqisni këtë informacion. Thjesht po ju
4 them, kur mund ta paraqisni këtë informacion.

5 Z. PROSPER: [Përkthim] Thjesht po jap kontekstin, pra,
6 thjesht duhet që të kemi parasysh rëndësinë e këtij
7 informacioni përpara sesa të vendosim afate kohore strikte.

8 Diçka që dua të ndaj me ju lidhur me këtë temë është një
9 letër që e kam marrë dje nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara,
10 do ta lexoj për ju. Ka të bëjë me afatet, prandaj dua ta
11 lexoj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Lexoni atë pjesë të letrës që ka të bëjë me afatet vetëm. Do
14 të pres.

15 Z. PROSPER: [Përkthim] Pra, në fakt, unë do t'ia jap një
16 kopje Trupit Gjykses, po dua që të jetë pjesë e
17 procesverbalit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po ju
19 kërkoj që të ndryshoni ose të sqaroni procesverbalin tuaj,
20 dokumentacionin tuaj. Thjesht pyetja ka të bëjë me afatet. Kur
21 mund të na e dorëzoni këtë informacion?

22 Z. PROSPER: [Përkthim] Në pjesën e fundit thuhet:

23 "Nuk parashikojmë dot plotësisht kohën sa i takon këtyre
24 vendimeve. Ne po punojmë me maksimumin e shpejtësisë së
25 mundshme".

1 Në qoftë se doni mund t'ju jap të gjithë letrën.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Ne nuk po
3 kërkojmë që të pranohen prova materiale sot, thjesht po ju
4 kërkoj disa përgjigje të pyetjeve të cilat janë të lidhura me
5 hapjen e provave të Mbrojtjes. Pra, është e rëndësishme që ju
6 të bëni më të mirën tuaj që të keni përgjigjet sa më shpejt
7 sepse në kundër mund të kemi probleme në të ardhmen.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, fole shumë
9 shpejt dhe nuk ju kapi zbardhësi. Ju folët për katër
10 dëshmitarë, deklaratat e tyre dhe përmbledhjet e tyre,
11 ndërkohë që në procesverbal u përmend vetëm 1DW7 edhe 1DW8. A
12 mund të na përmendni konkretisht se kush janë dhe këto dy
13 dëshmitarët e tjerë?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam përshtypjen që bëhet fjalë për
15 pesë, jo për katër dëshmitarë. Më lejoni një çast që të sqaroj
16 pak se cilët janë numrat e këtyre dëshmitarëve. Është 1DW006.
17 Përmbledhja e të cilit është nxjerrë, na është thënë që letra
18 që bën lejimin e nxjerrjes së informacionit nga Mbretëria e
19 Bashkuar do të vijë këtë javë dhe besoj që përmbledhjen e
20 këtij dëshmitari do ta keni brenda kësaj jave.

21 Ndërkohë që sa i takon dëshmitarëve të tjerë do t'i lexoj
22 dhe një herë për të qenë të qartë, është 1DW007, 1DW008,
23 1DW001 dhe 1DW004. Thjesht dua të shtoj diçka lidhur me atë
24 çfarë tha z. Prosper dhe dua që të shtoj që i kemi kërkuar
25 Qeverisë së Shteteve të Bashkuara që ta ndjekë konferencën për

1 përgatitjen e Mbrojtjes sot, kështu që në përgjigje të pyetjes
2 së Gjykatësit, ata janë plotësisht të informuar për pikën ku
3 jemi në këtë proces gjyqësor.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kemi dhe ne gjëra për të
6 thënë. Pra, ne e pranojmë që gjërat kanë ecur që prej mesit të
7 qershorit. Megjithatë mendojmë që është shumë e rëndësishme që
8 të jemi sa më të shpejtë që të jetë e mundur sepse afati, në
9 fakt, ka qenë dje, jo sot.

10 Po ashtu është e rëndësishme që ofruesve t'ju jepet
11 informacioni ose t'ju shpjegohet se pse është e rëndësishme që
12 ata të japin lejen ose autorizimin e tyre sa më shpejt të jetë
13 e mundur.

14 Pika tjetër që dëshiroj të përmend ka të bëjë me
15 përgatitjen tonë dhe këtë gjë dua t'jua them troç. Në
16 përgjithësi ne na nevojitet një muaj. Domethënë, nga momenti
17 kur të jenë nxjerrë të gjitha deklaratat dhe në deri në
18 momentin kur të vijnë e të japin dëshminë dëshmitarët, ne na
19 duhet një muaj. Z. Misetic tha që ka pesë dëshmitarë nga 11 që
20 do të thërrasë Ekipi i Thaçit, por ndërkohë që ne nuk kemi
21 autorizim dhe nuk kemi dokumentet e plota të këtyre personave.

22 Sa i takon, në veçanti, Dëshmitarit 1DW006, ai është i
23 katërti në radhë dhe neve na është thënë që përmbledhjen e
24 këtij dëshmitari do ta merrnim që dje, por në fakt edhe sot
25 nuk e kemi marrë. Kështu që ne do sugjeronim që këtë dëshmitar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 ta vendosnim të shtatin në radhë dhe ne mendojmë që kjo është
2 e rëndësishme.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë nuk ka asnjë bazë që të
4 kundërshtohet dhënia e dëshmisë së Dëshmitarit 1D6. Sepse ky
5 është një dëshmitar që do të japë dëshmi përpara Trupit
6 Gjykues. Nuk është dëshmitar sipas rregullës 154. Nuk ekziston
7 fare detyrimi që të ofrohet një deklaratë për këtë dëshmitar
8 por është thjesht vendimi ynë për të qenë më të hapur.

9 Ndërkohë që Prokuroria ka pasur më shumë se 30 ditë në
10 dispozicion lidhur me informacionin që ai do të japë këtu
11 përpara Trupit Gjykues, kështu që nuk është se ekziston më
12 detyrim shtesë për ne për të dhënë informacione shtesë për
13 këtë dëshmitar.

14 Sa i takon afatit, ju siguroj se çdo ofrues, që prej
15 urdhrit që keni dhënë herën e fundit, i është dhënë afati i 18
16 gushtit dhe për këtë arsye unë besoj se Dëshmitari 1DW003
17 është nxjerrë dje në mes të ditës në mënyrë të tillë që neve
18 t'jua jepnim informacionin sa më shpejtë të jetë e mundur.
19 Domethënë, dua të them që nuk është se ne nuk i kemi dhënë
20 afate më herët këtyre ofruesve të informacionit, por
21 pavarësisht afateve dhe gjithsesi z. Prosper mund t'ju japë më
22 shumë informacion, por mbase e dini dhe ju, që ka pasur
23 ndryshime në administratën e Shteteve të Bashkuara. Ka pasur
24 gjithashtu edhe ndryshime në Departamentin e Shteteve të
25 Bashkuara për Krimet e Luftës të Departamentit të Shtetit

1 përpara disa javëve që e kanë eliminuar Departamentin dhe
2 besojmë që kjo ka pasur edhe ndikimet e veta. Megjithatë, siç
3 mund ta kuptoni kjo është përtej kontrollit, nuk e
4 kontrollojmë dot këtë aspekt.

5 Z. Prosper ju ka dhënë parashtrime për sa i takon
6 rëndësisë së këtyre dëshmitarëve. Kemi marrë garanci për sa i
7 takon personave përkatës me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara
8 që ata janë të informuar për të gjitha zhvillimet dhe ne i
9 kemi bërë të gjitha planet mbi bazën e prezumimit që data e
10 nisjes së paraqitjes së provave për Mbrojtjen do jetë 15
11 shtatori.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do jetë
13 15 shtatori, por dua që të merrni parasysh seriozisht faktin
14 që këta persona t'i kaloni në fund të bllokut të dëshmitarëve
15 tuaj.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I kemi vendosur dëshmitarët të
17 cilët nuk kanë marrë autorizimin në fund. Synimi ynë është që
18 për ata dëshmitarë për të cilët nuk kemi marrë akoma lejen ose
19 autorizimin, ne t'i paraqesim ata në fund të bllokut të
20 dëshmitarëve.

21 Më lejoni që të shtoj edhe diçka tjetër. Besoj që e dini
22 që Prokuroria ka marrë urdhra që Mbrojtja nuk është lejuar që
23 të dinte ose të vihej në dijeni për identitetin e dëshmitarëve
24 të tyre deri 30 ditë përpara dëshmisë së tyre dhe i njëjti
25 rregull do të duhet të zbatohet dhe për ta.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Shqetësimi ynë është që ne nuk do
2 i kemi këto 30 ditë. Megjithatë, ajo çfarë tha z. Misetic nuk
3 është tërësisht e vërtetë, sepse Dëshmitari 1DW006 është në
4 rend për bllokun e parë dhe nuk është dhënë autorizimi ende
5 për të. Dhe kur them një muaj, në fakt, kjo rrjedh
6 drejtpërdrejt prej Urdhrit për Zhvillimin e Procesit. Në
7 paragrafin 74 jepen deklaratat që duhet që të ofrohen për sa i
8 takon rendit të dëshmitarëve.

9 Dhe paragrafi 73 na kërkon ne që të japim informacion të
10 plotë një muaj përpara përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit
11 të fundit në grupin e mëparshëm. Ne po kërkojmë të njëjtin
12 muaj që ka përdorur Mbrojtja, domethënë, po kërkojmë që ato
13 çfarë janë aplikuar për Mbrojtjen në rastin e thirrjes së
14 dëshmitarëve prej nesh të mund të aplikohet për ne tani.
15 Mendojmë që kërkojmë diçka të arsyeshme.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni të shtoj që rregulla 104
17 është e qartë që Mbrojtja nuk duhet të ofrojë ose të japë
18 asnjë deklaratë për dëshmitarët e saj.

19 Fakti që autorizimi do të vijë kësaj jave e bën këtë pak
20 si më të ndryshëm rastin si me Prokurorinë. Sepse Prokuroria
21 ka më shumë sesa një muaj në dispozicion për t'u marrë me
22 dëshmitarët. Ndërkohë që autorizimi në vetvete nuk ka të bëjë
23 me Prokurorinë, po ka të bëjë me ne. Ndërkohë fakti që do ketë
24 një deklaratë të nënshkruar, ndryshimi do jetë vetëm
25 nënshkrimi dhe kjo ka të bëjë vetëm thjesht me palët e tjera

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 15

1 dhe me Trupin Gjykses, por kjo nuk e ndryshon fare përmbajtjen
2 e tyre dhe nuk e ndryshon faktin që Prokuroria ka pasur kohë
3 të mjaftueshme për t'u përgatitur për marrjen në pyetje të
4 dëshmitarëve tanë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, a mund të bëj
6 një pyetje sa i takon nxjerrjes së informacionit për
7 Prokurorinë? A synoni që të organizoni seanca përgatitore
8 përpara dëshmisë së tyre me dëshmitarët ndërkombëtarë që do të
9 thërrisni?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, e synojmë këtë gjë, sepse
11 sikurse mund ta keni parë dhe dje nga parashtimi ynë, ne kemi
12 dokumente të caktuara të cilat ne kërkojmë që të pranohen
13 përmes këtyre dëshmitarëve. Kështu që ne duam që t'i
14 përgatisim këta dëshmitarë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Domethënë, juve shënimet e
16 seancave përgatitore me dëshmitarët tuaj, domethënë, do na i
17 bëni ne me dije, po do ia bëni dhe Prokurorisë me dije, apo
18 jo?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, nëse
21 keni ndonjë gjë për të thënë, ju lutem, ngrihuni dhe flisni,
22 nuk është qëllimi im që t'ju anashkaloj.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Pa diskutim, nuk është problem. Kam
24 diçka që dua të them, po mund ta them edhe më vonë gjatë
25 procesit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
2 zgjidhim këtë çështje ndoshta përmes një urdhri me shkrim duke
3 përcaktuar një afat kohor që ne e ndjejmë dhe e mendojmë si të
4 drejtë për të gjitha palët. Faleminderit për kontributin tuaj
5 lidhur me këtë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem edhe një çast në qoftë se
7 mundem.

8 Duhet të kisha thënë dhe një diçka tjetër dhe harrova ta
9 them. Lidhur me Dëshmitarin 006, ne e kemi përcaktuar rendin
10 duke marrë parasysh disponueshmërinë ose kohën që kanë
11 dëshmitarët për të ardhur dhe për të dhënë dëshmi këtu. Kjo
12 është në veçanti e vërtetë dhe e rëndësishme për dëshmitarin
13 006 dhe në qoftë se ai nuk mund të vijë gjatë kësaj kohe
14 pastaj duhet që të bëjmë organizimet përkatëse.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndërkohë që jeni në këmbë,
16 nuk jam i qartë lidhur me atë çfarë thatë, domethënë, ju thatë
17 që deklarata e Dëshmitarit 006 është nxjerrë, apo jo?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk është nxjerrë sepse nuk
19 kemi marrë autorizim nga Mbretëria e Bashkuar për ta nxjerrë
20 këtë informacion, megjithatë mund të them që në mënyrë
21 joformale, na është thënë që leja do të na vijë këtë javë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se mund t'ju ndihmoj, ky
23 informacion jepet në parashtrimin e Mbrojtjes së Thaçit që
24 mban numrin F034606F0 ku thuhet që nuk e kanë marrë akoma
25 lejen për përfundimit e dhënies së informacionit përkatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
2 Në pajtim me rregullën 119(3) ka çështje të caktuara që Trupi
3 Gjykses mund t'i trajtojë në seancën për përgatitjen e
4 çështjes. Dhe këtu rikujtoj që mund të përcaktoj numrin e
5 dëshmitarëve që Mbrojtja mund të thërrasë dhe, të udhëzojë
6 Mbrojtjen për heqjen e dëshmitarëve përsëritës, të përcaktojme
7 kohën e disponueshme për Mbrojtjen për paraqitjen e provave
8 ose t'i kërkojmë Mbrojtjes që të shkurtojë kohëzgjatjen e
9 vlerësuar të marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tyre.

10 Ndërkohë që këto hapa janë brenda kompetencës së Trupit
11 Gjykses, Trupi Gjykses vlerëson se mënyra e prezantimit është
12 kryesisht përgjegjësi e palës thirrëse dhe nuk shikon ndonjë
13 problem me listën e dëshmitarëve aktualisht.

14 Tani, dëshiroj që t'ju kërkoj Mbrojtjeve të z. Thaçi dhe
15 z. Krasniqi t'i përgjigjen disa pyetjeve. Së pari, sa i takon
16 mënyrës së dhënës së dëshmisë. Çështja e parë që Trupi Gjykses
17 dëshiron të trajtojë është mënyra në të cilën dëshmitarët e
18 Mbrojtjes do të japin dëshmitë e tyre.

19 Në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes, Mbrojtja
20 e Thaçit e informoi Trupin Gjykses që synon që të thërrasë 11
21 ose 12 dëshmitarë që të japin dëshmi në sallën e gjyqit dhe
22 disa prej këtyre dëshmitarëve do të japin dëshmi përpara
23 Trupit Gjykses ose mund të jenë dëshmitarë sipas rregullës 154
24 në varësi të autorizimit sipas rregullës 107. Mbrojtja e
25 Krasniqit informoi Trupin Gjykses që do të ketë dy dëshmitarë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 18

1 sipas rregullës 154, dy dëshmitarë sipas rregullës 153 dhe një
2 dëshmitar sipas rregullës 155.

3 A mund të na e sqaroni në qoftë se pozicioni është ende
4 ky?

5 Duke filluar me Mbrojtjen e z. Thaçi.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Që prej Konferencës së fundit për
7 Ecurinë e Çështjes, ne konfirmuam tashmë që 1DW006 dhe 1DW008
8 do të jenë dëshmitarë që do të vijnë në sallën e gjyqit dhe
9 nuk do të jenë dëshmitarë sipas rregullës 154. Pjesa tjetër
10 është sikurse ka qenë më përpara.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka më gjëra
12 që nuk i keni të qarta ose nuk i dini me siguri?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ellis, juve?

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Është ekzaktësisht atë çfarë thatë
16 ju. Po ashtu dëshiroj që të theksoj që edhe ne synojmë që të
17 mbajmë seanca për përgatitjen e dëshmitarëve për ata
18 dëshmitarë të cilën nuk do të japin dëshmi sipas rregullës
19 154.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duke u
21 mbështetur në pyetjen e mëparshme, Trupi Gjykses dëshiron që
22 t'i kërkojë z. Thaçi, Mbrojtjes së z. Thaçi dhe z. Krasniqi që
23 të na përditësojë në qoftë se ka ndonjë ndryshim sa i takon
24 kohës për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të tyre apo jo.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëmë përditësimin dje dhe do na

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 19

1 duhen gjithsej 35.5 orë. Kjo kryesisht për faktin sepse këta
2 dy dëshmitarët, që menduam më përpara që do të ishin
3 dëshmitarë sipas rregullës 154, tani do të vijjnë do të japin
4 dëshmi në sallën e gjyqit. Megjithatë do të duhet që të
5 diskutojmë dhe me Prokurorinë për të parë në qoftë se disa
6 prej dokumenteve që janë në listën tonë mund të pranohen
7 përmes dakordsisë përmes nesh dhe Prokurorisë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe Mbrojtja
9 e z. Krasniqi?

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka ndryshuar asgjë. Është i
11 njëjti vlerësim siç kemi pasur edhe më përpara.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Ju keni dëshmitar të rregullës 154?

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Kemi dy dëshmitarë të rregullës 154.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ja keni
16 dorëzuar materialet Prokurorisë lidhur me këta dëshmitarë?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, deklaratat ua kemi dhënë,
18 përpara seancës së fundit madje që kemi pasur ia kemi
19 dorëzuar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i përket
21 radhës së dëshmitarëve, si synoni ju t'i thërrisni të japin
22 dëshmi në sallën e gjyqit *live* apo sipas rregullës 154? Ju
23 lutem, Mbrojtja të na përditësojë nëse ka ndonjë informacion
24 të mëtutjeshëm lidhur me rendin e dëshmitarëve - e diskutuam
25 në fakt shkurtimisht - po mbase kjo do të na shërbente sesi do

1 të jetë radha e dëshmitarëve. Vetëm për përditësime do ju
2 lutesha të na e jepnit.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Në materialin që dorëzuar sot
4 paradite, ne kemi tentuar të kemi një radhë të dëshmitarëve.
5 Kemi katër dëshmitarët që diskutuam për të cilët pritet ende
6 autorizimi dhe këta dëshmitarë janë në bllokun e fundit të
7 dëshmitarëve tanë. Ky është synimi ynë deri tani dhe kjo duhet
8 të mbahet parasysh dhe të keni parasysh faktin që ne presim të
9 marrim autorizimin sa më shpejt që të jetë e mundur, por këta
10 dëshmitarë si rregull do të vijnë në tetor.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
12 Krasniqit, ka gjë për të shtuar?

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar. Ne
14 kemi vetëm dy dëshmitarë që do të thërrasim dhe do t'i
15 thërrasim sipas rendit që e kemi dorëzuar tashmë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Faleminderit.

18 ZPS-ja ka diçka për të thënë lidhur me këtë?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, përveç atyre që diskutuam
20 tashmë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe pak javë
22 na kanë ngelur përpara se të fillojë Mbrojtja me provat e
23 veta, mund ta shfrytëzojmë këtë kohë mbase lidhur me rendin e
24 dëshmitarëve në mënyrë që të funksionojë për të gjithë. Që t'i
25 japim dhe Prokurorisë njoftimin përkatës në kohën e duhur edhe

1 ju të keni mundësi të përfundoni rendin e dëshmitarëve tuaj.

2 Kanë ngelur dhe 35 ditë, ditë punë më saktë, që sot deri
3 në dhjetor dhe mendoj që kemi mundësi, kemi fleksibilitet,
4 besoj se pesë orë në ditë do të mjaftojnë për t'i përfunduar
5 dëshmitarët e parashikuar.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, po, pajtohem. Për ne s'ka
7 asnjë problem. Dhe unë e vlerësoj këtë, sepse -- do përdor
8 fjalët e z. Prosper, duke pasur parasysh sa të rëndësishëm
9 janë këta persona, nuk është e lehtë për ne që t'i kemi këtu
10 kur duam ne apo të vijnë njëri pas tjetri. Dhe ne s'e kemi as
11 luksin që ka ZPS-ja për të përcaktuar kohën e caktuar që na
12 nevojitet ne për t'i marrë në pyetje, por është shumë e
13 rëndësishme që të kemi fleksibilitet sepse nuk mund të themi
14 që këtë dëshmitar do ta kemi më 15 shtator e atë dëshmitar do
15 ta kemi më 16 shtator.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë s'e di ç
17 nënkupton ti me fleksibilitet. Ne ditët i kemi të caktuara.
18 Duhet të shfrytëzoni ditët që kemi caktuar.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Brenda afatit që thatë ju. Brenda
20 afatit që thatë ju pak më herët mendoj se mund t'i kemi të
21 gjithë dëshmitarët që kemi caktuar, mbase duke marrë parasysh
22 këtu edhe pyetjet që do të kenë Gjykatësit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjithashtu i
24 kërkoj Mbrojtjes së Thaçit që të marrë parasysh faktin se nëse
25 një ose më shumë se dy dëshmitarë do të kenë dhe një

1 përfaqësues nga organizata apo nga shteti përkatës, është mirë
2 që këta dëshmitarë të vijnë pas njëri-tjetrit në mënyrë që të
3 organizojmë logjistikën, transportin e tyre. Sepse do t'i
4 shërbente kjo edhe Trupit Gjykues edhe Zyrës Administrative në
5 mënyrë që këta dëshmitarë që do të kenë shoqërues të vijnë
6 njëri pas tjetrit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk jemi të sigurtë ende për
8 ofruesin që është autorizuar 1D005, 006, por ju mund ta shihni
9 që ne i kemi vendosur këta njëri pas tjetrit dhe besojmë se
10 nuk ka probleme për këtë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të na
12 shërbente shumë kjo gjë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Ka dhe diçka tjetër që mund të
14 jetë problem. Do ta shihni që për Dëshmitarin 003 që është në
15 bllokun e parë të dëshmitarëve dhe dëshmitarët e tjerë janë po
16 ashtu të rëndësishëm por ne i kemi në bllokun e fundit këta
17 dëshmitarë dhe nuk mund t'i japim njoftimet përkatëse në kohë
18 të mjaftueshme paraprakisht Prokurorisë lidhur me këta
19 dëshmitarë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Faleminderit.

22 Ka diçka për të thënë ZPS-ja lidhur me këtë?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, lidhur me këtë pikë nuk kemi
24 asgjë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a

1 keni ju diçka?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë
4 tani me mocionet e rregullës 153, 155.

5 Në konferencën e 22 korrikut 2025, Trupi Gjykses u
6 propozoi palëve që të komunikojnë me njëri-tjetrin sa i takon
7 datës për dorëzimin e mocioneve sipas rregullës 153 dhe 155,
8 do t'i shërbente veçanërisht Trupit Gjykses t'i kishim këto
9 mocione sa më shpejt që të jetë e mundur sepse këto kërkojnë
10 shumë kohë në mënyrë që t'u përgjigjemi dhe t'i trajtojmë dhe
11 ne duam t'i shqyrtojmë dhe t'u përgjigjemi siç duhet.

12 Ka ndonjë përditësim nëse keni diskutuar me njëri-
13 tjetrin, nëse keni rënë dakord për një datë? Veçanërisht,
14 Ekipi i Mbrojtjes së z. Thaçi dhe z. Krasniqi a mund të na
15 thonë se kur synojnë t'i dorëzojnë këto mocione?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Fatkeqësisht, ne nuk kemi
17 kontaktuar lidhur me këto me Prokurorinë, por ne synojmë të
18 dorëzojmë mocionet sipas rregullës 153 përpara 15 shtatorit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'i
20 dorëzoni pak më herët?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të bëjmë të pamundurën, po një
22 mocion kemi në fakt sipas rregullës 153. 155, rregulla 155,
23 për këtë, pra, mocion për rregullën 155 ne nuk kemi, po kemi
24 një dëshmitar në listë që mbase do të jetë objekt i kësaj
25 rregulle, megjithatë do të shikojmë si do të jenë zhvillimet

1 lidhur me këtë dëshmitar.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne kemi tre dëshmitarë për të cilët
3 do dorëzojmë mocione: Dy sipas rregullës 153 dhe një është
4 sipas rregullës 155. Këtë do ta bëjmë së bashku në një
5 dokument të vetëm. Gjithashtu, ne synojmë ta bëjmë këtë
6 përpara 15 shtatorit, pra, përpara fillimit të paraqitjes së
7 provave prej Mbrojtjes.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse do të
9 caktonim ne një afat lidhur me këto mocione të jeni të sigurtë
10 që nuk do jepnim datën 15 shtator por një datë më të hershme,
11 më thoni, pra, një datë kur mendoni që jeni gati të dorëzoni
12 mocionet përkatëse? Me fjalë të tjera, 5 shtator, për
13 shembull, është e mundur të dorëzoni, 10 shtator?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Të paktën më 10. Nëse më jep dy
15 alternativa, atëherë unë zgjedh datën 10.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po të jap
17 datën 9.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Më tingëlloi më mirë data 10.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
20 Krasniqit?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ndihmon kjo
23 ZPS-në, është dakord ZPS-ja për këtë datë?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Po, po. Dakord është dhe për ne
25 dhe kemi kohë të mjaftueshme t'u përgjigjemi.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
2 Mettraux.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje z. Halling
4 lidhur me Dëshmitarin 1D002, që është dëshmitar sipas
5 rregullës 153. Ju nuk e keni marrë kërkesën e Mbrojtjes së
6 Thaçit, por nëse dëshmitari do të japë dëshmi lidhur me atë që
7 synon që të japë dëshmi, do të kundërshtoni ju që të pranohet
8 dëshmia e këtij sipas rregullës 153, me aq sa keni dijeni?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Pa parë kërkesën është e vështirë
10 që të përgjigjem. Për ne problematika është që ky është një
11 dëshmitar i rregullës 154 për Mbrojtjen për e Krasniqit dhe
12 unë nuk e di a duhet të jetë objekt i rregullës 153 apo mund
13 të zgjidhet kjo sipas rregullës 154 në mënyrë që ky dëshmitar
14 të japë dëshmi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po a e keni
16 kontaktuar ju Mbrojtjen e Krasniqit për këtë?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt, po prinim të na
18 kontaktonin ata, po megjithatë unë e hodha idenë tani dhe mund
19 ta diskutojmë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
21 jeni më proaktiv. Takohuni, diskutojini këto sepse nuk keni
22 shumë kohë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është problem. Ne mund ta
24 diskutojmë, po nga pikëpamja procedurale ky dëshmitar është
25 dëshmitari i Krasniqit dhe për këtë aspekt. Dhe unë po hezitoj

1 sepse unë nuk mund, kur të përfundoj me provat e mia, unë nuk
2 mund të kontrolloj çfarë ndodh në Mbrojtjen e Krasniqit. Mbase
3 ky dëshmitar nuk përmbush kërkesën e rregullës 154, mbase do
4 jetë nevoja ta rithërrasim këtë dëshmitar. Megjithatë këtë
5 mund ta diskutojmë më vonë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Diskutojeni
7 me njëri-tjetrin, pajtohuni me njëri-tjetrin, por kjo është
8 përgjegjësia jonë përfundimisht. Do t'ua japim ne zgjidhjen si
9 ta gjykojmë ne më mirë atëherë.

10 Në seancën e 22 korrikut 2025, Mbrojtjet e Krasniqit dhe
11 Thaçit informuan Trupi Gjykses se me përjashtim të një
12 dëshmitari nuk synojnë të kërkojnë masa mbrojtëse për
13 dëshmitarët e tjerë. Ka ndryshuar gjë lidhur me këtë? Mund të
14 na e konfirmoni këtë, e keni diskutuar me dëshmitarët ju nëse
15 ata kanë nevojë apo jo për masa mbrojtëse?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, e drejtë është, sigurisht, ka
17 një dallim mes masave mbrojtëse dhe masave sipas rregullës
18 107. Ne nuk i kemi pyetur këta dëshmitarë nëse kanë nevojë për
19 masa mbrojtëse, por disa prej ofruesve të informacionit kanë
20 kërkuar për masa sipas rregullës 107, pra, mbrojtjen e
21 informacionit përpara sesa të japin dëshmi këta dëshmitarë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ellis?

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, ne nuk kemi asgjë për momentin
24 ndryshe.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka përgjigje?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Për ne problemi është veçanërisht
2 rregulla 107, sepse kërkon një afat tri javë përpara dhënies
3 së dëshmisë. E njëjta gjë kjo me afatet e rregullës 154.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni të
5 përgjigjeni, Misetic, të jepni ndonjë afat ju lidhur me këtë,
6 propozoni ndonjë afat?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa u takon dëshmitarëve në bllokun
8 e parë, tri javë - ne e kemi kaluar afatin tri javor më duket
9 - më duket se këtë javë bëhen tri javë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë javë.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë nuk do të kem mocione
12 sipas rregullës 107 për këta dëshmitarë këtë javë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
14 dorëzoni mocionet javën tjetër?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Javën tjetër s'është problem, mund
16 t'i dorëzojmë.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, mendoni ju se
18 këta dëshmitarë sipas rregullës 107 do të japin dëshmi
19 publikisht?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mund ta them me 100 për qind
21 mund të ketë edhe segmente që duhet të jenë në seancën
22 private, por synimi ynë është që seanca të jetë përgjithësisht
23 publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sipas
25 rregullës 119(3)(d) dhe dua të konfirmoj me Mbrojtjen e Thaçit

1 që nuk ka ngelur gjë e pazgjidhur sa i takon detyrimeve për
2 nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 104(5), përveç atyre
3 që kemi diskutuar tashmë dhe dua një përditësim lidhur me
4 dokumentet që diskutuam herën e fundit në seancën përgatitore.
5 A mund të na thoni sa dokumente sipas rregullës 107 kërkojnë
6 ende autorizim dhe kur mendoni se mund ta merrni këtë
7 autorizim?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon dokumenteve që kanë
9 mbetur që kërkojnë autorizim sipas rregullës 107, janë vetëm
10 dy syresh. Një e diskutuam, lidhet me Dëshmitarin 1D006, pra,
11 është deklarata e panëshkruar që shpresojmë se do të zgjidhet
12 këtë javë edhe ka të bëjë dhe me Dëshmitarin 003, po ashtu
13 është deklarata e panëshkruar që mendojmë që do të zgjidhet
14 këtë javë dhe ua kemi dhënë mbrëmë.

15 Sa u takon dokumenteve të tjera sipas rregullës 107, janë
16 autorizuar nga ofruesit e informacionit.

17 Sa i takon detyrimeve tona, për të gjitha dëshmitë, për
18 të gjithë dëshmitarët që nuk janë sipas rregullës 107, janë
19 nxjerrë dokumentet përkatëse. Për të gjithë dëshmitarët sipas
20 rregullës 107 deklaratat e autorizuara për nxjerrje sipas
21 rregullës 107 ose janë nxjerrë ose do të nxirren brenda një
22 afati të arsyeshëm, pra, në momentin që të marrim autorizimin
23 përkatës.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo na interesoi më shumë, sepse
25 nuk e kemi të qartë tani çfarë detyrimi ka Mbrojtja sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 29

1 nxjerrjes së informacioneve. E diskutuam në korrik po e
2 diskutojmë edhe sot. Nëse do na nxjerrin, do na japin
3 deklaratat, ne nuk kemi asnjë arsye të diskutojmë këtu.
4 Veçanërisht kemi merak Dëshmitarin 006, ne duam të kuptojmë
5 çfarë detyrimi mendon Mbrojtja se ka lidhur me këtë dëshmitar
6 dhe a e kanë të qartë ata që dhe ne kemi të drejtë që të
7 marrim informacionin përkatës lidhur me këtë?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni diçka
9 për të shtuar?

10 Gjithashtu dëshirojmë të konfirmojmë me Mbrojtjen e
11 Krasniqit nëse kanë respektuar detyrimet për nxjerrjen e
12 informacioneve sipas rregullës 104(5) siç është konfirmuar në
13 konferencë e fundit në korrik dhe që dokumentet për të cilat
14 pritej ende autorizimi sipas rregullës 107 tashmë janë
15 nxjerrë?

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, konfirmoj këtë gjë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Gjykatësi Mettraux.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një sqarim nga ju, z.
20 Misetic. 10 shtatori vlen edhe për dëshmitarët e rregullës
21 154?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Sikurse ua thamë në dokumentin që
23 dorëzuam dje, për dëshmitarët e rregullës 154 që janë në
24 bllokun e shtatorit, mocionet do t'i dorëzojmë brenda kësaj
25 jave.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po për dëshmitarët e tjerë
2 kur të merrni autorizimin?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kur të marrim autorizimin.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rikujtojmë që
5 në dokumentin F03371, informoi palët dhe pjesëmarrësit dhe
6 synonte të caktonte datën për fillimin e paraqitjes së provave
7 prej Mbrojtjes për të hënën, 15 shtator 2025. Trupi Gjykues ka
8 dëgjuar parashtime të shtjelluara lidhur me këtë pikë,
9 sidoqoftë ne mund t'i japim të drejtën palëve të shtojnë diçka
10 nëse kanë ndonjë përditësim që gjykojnë se mund të ketë ndikim
11 në këtë datë. Ne kemi parasysh faktin që Mbrojtja i mbylli
12 provat e veta më 15 prill dhe i ka miratuar një shtyrje afati
13 Mbrojtjes për fillimin e provave të veta.

14 Ka ndonjë gjë për të trajtuar tani lidhur me këtë datë,
15 përveçse atyre që diskutuam tashmë, ka diçka të re për të
16 shtuar?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Ne e kemi të qartë që duhet të
18 fillojmë më 15 shtator dhe me këtë datë në mendje kemi punuar
19 dhe do përpiqemi të organizojmë rendin e dëshmitarëve.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
21 Krasniqit?

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, s'kemi asgjë për të shtuar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta pyes
24 dhe z. Dixon se nuk ia kemi dëgjuar zërin tërë këtë kohë, ju,
25 z. Dixon mendoni se duhet ta shtyjme këtë datë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 31

1 Z. DIXON: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po Mbrojtja e
3 Selimit ka diçka për të thënë?

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të thënë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a
6 gjykoni ju se duhet shtyrë kjo datë?

7 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të thënë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ZPS-ja?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Asgjë dhe ne. Ne jemi gati.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Duhet të japim një urdhër me gojë.

12 Pasi të dëgjojmë palët dhe pjesëmarrësit sipas rregullës
13 119(4), atëherë caktojmë datën 15 shtator 2025, që është ditë
14 e hënë, për fillimin e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

15 Kalendari është hedhur në fakt në KOSMOS, mbase e keni
16 parë. Do bëhet një ndryshim. Data 25 shtator, që i takon të
17 jetë e enjte është një datë që ne nuk jemi të disponueshëm
18 edhe atë datë do ta anulojmë. Menduam një herë të bënim një
19 seancë vetëm paradite, por nuk mundemi as për paraditen.
20 Kështu që keni parasysh që më 25 shtator, që është e enjte,
21 atë ditë nuk do të kemi seancë pra. Ndërsa datat e tjera
22 ngelen siç janë në KOSMOS. Kalendari përfundimtar do të
23 dorëzohet përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës edhe do
24 të jetë dhe në KOSMOS sapo të jetë gati.

25 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

1 Tani të kalojmë tek pjesa e programit. Sipas rregullës
2 119(4), do të caktojë dhe një datë për mbylljen e provave të
3 Mbrojtjes sipas rregullës 131.

4 Për ta ndihmuar Trupin Gjykues që të caktojë këtë datë të
5 synuar, kuptohet për mbylljen e provave, dëshiroj të pyes
6 Mbrojtjen e Thaçit dhe të Krasniqit, sa kohë mendoni ju se do
7 t'ju nevojitet për paraqitjen e provave tuaja dhe kur mendoni,
8 me përafërsi, se do të përfundoni paraqitjen e provave tuaja?

9 Po filloj me Mbrojtjen e z. Thaçi.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, më duket se ju thatë
11 deri në dhjetor, apo jo, na dhatë si afat si dritare kohore
12 shtator-dhjetor.

13 Ne mendojmë se deri në dhjetor do të kemi përfunduar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne propozojmë këtë, deri në fund
16 të nëntorit të përfundojmë me të gjitha dëshmitë, pastaj të na
17 jepet pak kohë më mbrapa, njësoj si dhe Prokurorisë, mbase ka
18 ndonjë mocion që s'e kemi dorëzuar ende dhe duhet trajtuar,
19 mund të kemi mocione për prova jогоjore, sidomos për dokumente
20 që nuk do të dorëzohen, që nuk do të pranohen përmes
21 dëshmitarëve dhe ta mbyllim dhe ne paraqitjen e provave njësoj
22 si Prokuroria.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju pyes
24 dhe një herë për mocionin e provave jогоjore dhe ma jepni
25 përgjigjen të drejtpërdrejtë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtë bëj gjithmonë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Herën e
3 fundit s'isha shumë i qartë çfarë më the. Ju lutem, më thoni
4 sa më shpejt kur mund t'i dorëzoni këto? Unë kuptoj që këto
5 zakonisht dorëzohen në fund, po nuk besoj se do të keni 40, 50
6 mocione ditën e fundit, afatin e fundit?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë e kuptoj që nëse dorëzohen
8 mocionet ditën e fundit, është një angazhim shumë i madh për
9 ju sikurse ishte dhe për ne. Ne do përpiqemi t'i dorëzojmë
10 mocionet në mënyrë graduale. Po do të kemi një ose dy mocione
11 për prova jogojore që do dorëzohen përpara 15 shtatorit. Mund
12 të ketë dhe të tjera gjatë kohës që do të fillojmë me
13 dëshmitë. Por do të doja të kisha mundësi që të më jepet kohë
14 në fund për çdo dokument që ka ngelur i padorëzuar që t'i
15 dorëzojmë pastaj këto dokumente si mocion për prova jogojore.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
17 Krasniqit?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Po. Sa i takon afatit për provat
19 tona, tani unë po flas pa marrë parasysh edhe kundërpjetet,
20 po për dy dëshmitarët e rregullës 154 që do të kemi ne, mendoj
21 që ne na duhet një javë jo më shumë.

22 Tani, është e vështirë të them unë kur do të përfundojmë
23 me provat tona sepse varet se kur do të fillojmë ne me
24 dëshmitarët tanë, sepse ne varemi nga Mbrojtja e z. Thaçi.

25 Sa i takon mocioneve jogojore, ne planifikojmë t'i

1 dorëzojmë po ashtu gradualisht. Ka të ngjarë që të kemi një
2 mocion që do dorëzohet në fund fare. Ndërsa për mocionin e
3 parë nuk ua them dot me siguri nëse do të jemi gati përpara 15
4 shtatorit, por ne do të përpiqemi, do të përpiqemi që
5 gradualisht të dorëzojmë mocionet përkatëse.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, se ju jeni
7 shënjestra jonë për sot.

8 Ju na dhatë një parashikim kohor prej 35 orësh e gjysmë
9 për dëshmitarët tuaj. Sipas llogarisë që bëra unë, janë shtatë
10 ditë dëshmi nga pala thirrëse. Po shtojmë dhe shtatë ditë nga
11 pala kundërshtare, pra, për kundërpyetjet, që i takon rreth 14
12 ditë dëshmi. Si arritët deri në dhjetor ju me këto data?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po pak më përpara ne diskutuam
14 problemin e këtyre dëshmitarëve që t'i kemi njëri pas tjetrit
15 dhe ky është një problem. Sigurisht, nëse do mundesha unë do
16 të doja t'i sillja njëri pas tjetrit këto dëshmitarë, po unë
17 s'ua premtoj dot këtë, duke marrë parasysh që disa prej këtyre
18 personave kanë angazhime, kanë agjendat e tyre.

19 Sigurisht unë nuk dua të lë shumë kohë midis dëshmitarëve
20 por unë u bazova në vlerësimin që na dha Gjykatësi Smith dhe
21 ju thashë që unë do përpiqem që të përfundoj deri në fund të
22 nëntorit. Idealisht ne mund të përfundojmë edhe deri në fund
23 të tetorit. Por do të doja që të më jepej fleksibiliteti që u
24 përmend më herët, në mënyrë që ta kem dhe nëntorin në
25 dispozicion në rast se do kemi probleme me datat. Por po ua

1 them që synimi im është të përfundojmë deri në fund tetorit.

2 Ne nuk e kemi kalendarin për tetorin dhe nëntorin siç e
3 keni ju. Nuk na është dhënë. Por do përpiqeshim, do të donim
4 të bënim të njëjtën gjë, tre javë me dëshmitarë, dy javë
5 pushim dhe kështu me radhë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Që sot deri
7 në nëntor i takon 30 ditë pune me pesë orë në ditë, i takon
8 150 orë dëshmi. Besoj që kaq mjafton.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Po ua them dhe një herë, idealisht
10 ne duam të përfundojmë brenda bllokut të parë që janë tri javë
11 që është brenda tetorit. Por ju keni të drejtë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por ne mund
13 të caktojmë një datë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po unë po ju them aq sa kam
15 mundësi, mendoj se kaq kohë më nevojitet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Ka diçka për të shtuar nga Mbrojtja e Krasniqit?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Thjesht dua të shtoj që mund të kemi
19 dhe ne pyetje për disa prej dëshmitarëve të z. Thaçi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ma merr
21 mendja që po.

22 Z. ELLIS: [Përkthim]

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Ma merr mendja se dhe ekipet e
24 tjera të Mbrojtjes.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Madje mund të

1 ketë dhe Prokuroria pyetje.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të ketë edhe Gjykatësi Mettraux
3 pyetje.

4 Z. PACE: [Përkthim] Do të doja të kishim disa sqarime
5 gjithashtu për Ekipet e tjera të Mbrojtjes, sa kohë mendojnë
6 se u nevojitet ekipeve të tjera të Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të
7 Viktimave për të bërë pyetje? Ne nga ana jonë do t'ju japim
8 brenda shtatë ditësh parashikimet tona kohore lidhur me këta
9 dëshmitarë, në përputhje me urdhrin që keni nxjerrë ju,
10 veçanërisht sipas paragrafit 74, që do të thotë, brenda javës
11 tjetër ne do të japim parashikimet tona, por do të donim që të
12 kishim edhe parashikimet kohore prej ekipeve të tjera në
13 mënyrë që të kuptojmë çfarë është e realizueshme, çfarë nuk
14 është e realizueshme brenda afatit të caktuar.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe unë kam parasysh afatin shtatë
16 ditor dhe brenda shtatë ditëve do dorëzojmë parashikimet
17 konkrete.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka gjë për të
19 shtuar?

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam një pyetje për z. Dixon
21 dhe z. Roberts.

22 Aktualisht mendoni ju se do të bëni pyetje të shtjelluara
23 të dëshmitarëve që do të vijjnë për dy ekipet e tjera të
24 Mbrojtjes?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Aq sa mund t'ju them

1 tani, ne nuk do të kemi kundërpyetje shumë të gjata, por do të
2 kemi nevojë të bëjmë pyetje lidhur me disa aspekte, sigurisht,
3 kjo në varësi të provave që do të paraqiten, të deklaratave që
4 do të jepen, por nuk mendoj që do të jenë shumë të gjata
5 pyetjet tona. Nuk mund t'ua them me 100 për qind tani, po do
6 t'ju bëjmë pyetje disa dëshmitarëve, kjo është e drejtë.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, ne jemi në situatë të
8 ngjashme. Ju kemi dorëzuar një mocion ju, si Trupi Gjykses,
9 lidhur me fushë veprimin e kundërpyetjeve të Prokurorisë për
10 disa prej dëshmitarëve të Mbrojtjes. Kështu në varësi të
11 vendimit që do të merrni ju, do të japim ne një përllogaritje
12 më të saktë. Por jemi në situatë të ngjashme. Por nuk synojmë
13 të bëjmë pyetje shumë të shtjelluara, nuk do të kërkojmë shumë
14 kohë për pyetjet tona.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Dua t'i përgjigjem pyetjes së z.
17 Pace, po për këtë do të duhet të kalojmë në seancë private.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
19 seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë private)

Faqe 38

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

20 Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Trupi Gjykses dëshiron të konfirmojë me Mbrojtjen

23 qëndrimin e tyre përfundimtar sa i takon mocioneve për

24 pranimin e materialeve si prova jогоjore dhe konstatimin

25 gjyqësor të faktit të shqyrtuar në proceset e tjera dhe kjo

1 është pjesë e madhe e procesverbalit.

2 Tani që të trajtojmë mocionet e mundshme për pranim,
3 mocionet për prova jogojore, do të donim të qartësonim me
4 Mbrojtjen nëse ata e dinë sesa mocione për prova jogojore
5 synojnë të parashtrojnë, sa dokumente do të kërkojnë që të
6 pranohen si prova jogojore, nëse këto mocione do të
7 përqendrohen tek tema të caktuara dhe nëse është kështu cilat
8 janë këto tema dhe nëse ata parashohin dorëzimin e mocioneve
9 të tilla për më tepër.

10 Ndërsa, ndonëse Mbrojtja e Thaçit ka parashtuar se ata
11 do të parashtrojnë mocionet për pranimin e provave jogojore në
12 fund, në përfundim të çështjes, Trupi Gjykses thekson se sa më
13 shpejt që Mbrojtja të fillojë parashtrimin e mocioneve për
14 prova gojore, aq më shpejt këto çështje do të zgjidhen. Trupi
15 Gjykses dëshiron që ta bëjë të qartë gjithashtu se mund të
16 vendosë vetë një afat kohor për parashtrimin e mocioneve të
17 tilla që mund të krijojnë, pra, ngarkesë pune në fund të
18 çështjes së Prokurorisë lidhur me këto çështje.

19 Fillojmë me Mbrojtjen e z. Thaçi.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, ne kemi diskutuar
21 afatet kohore për mocionet e për pranimin e provave jogojore.
22 Nuk do të paraqesim mocion për faktet e shqyrtuara në proceset
23 e tjera dhe kjo nuk është çështje, pra, nuk është problem për
24 ne. Ne dimë pak a shumë në vija të përgjithshme se ato që do
25 të parashtrojmë, atë që presim dhe presim të parashtrojmë

1 katër apo pesë mocione për pranim të provave jogojore. Ne do
2 të përpiqemi që t'i përmbledhim ato në disa tema. Nuk jam në
3 gjendje t'ju them sot cilat janë këto tema në mënyrë konkrete
4 dhe specifike. E di që do të jenë, do ta shihni së shpejti
5 listën e provave materiale të grumbulluara rreth vendndodhjeve
6 të z. Thaçi. Dhe do të shikoni në mocionin për pranimin e
7 provave jogojore se kjo është se ai ka qenë jashtë vendit,
8 jashtë shtetit, pra, në periudhën që mbulon aktakuza nga mesi
9 i nëntorit deri në 18 qershor, me përjashtim të periudhës në
10 mes apo më pak se 60 ditë dhe ky është mocion, mocioni për
11 pranimin e provave gojore do të jetë lidhur me këtë. Këtë do
12 të mendojmë se do ta paraqesim përpara datës 15 shtator.

13 Sa i takon numrit apo sasisë, në përgjithësi mendojmë siç
14 e keni parë se janë 850 dokumente në listën tonë të provave
15 materiale, do të jenë ndarje 50/50, 50 për qind të dokumenteve
16 që do të përpiqemi t'i parashtrojmë përmes dëshmitarëve dhe 50
17 përqindëshi tjetër, 425 dokumente përafërsisht, si prova
18 jogojore. Por këto janë vlerësime natyrisht në këtë fazë që
19 jemi.

20 Sa i takon afatit kohor, siç e përmendëm më herët, që
21 lidhet me temën tjetër. Kemi biseduar, kemi përmendur fundin e
22 tetorit. Dhe kjo nuk merr parasysh kohën shtesë që do të
23 kërkojmë për mocion për prova jogojore, shtesë që mund të kenë
24 ngelur pas prezantimit, pas dhënies së dëshmisë nga ana e
25 dëshmitarëve.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

2 Mbrojtja e Krasniqit.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 Faktet e shqyrtuara në proceset e tjera. Ne nuk kemi marrë

5 këtë vendim akoma, vendimin përfundimtar, por ka një apo dy

6 gjëra që duhet t'i kontrollojmë në mënyrë që të jemi në

7 gjendje të bëjmë këtë përpara 15 shtatorit, pra, fillimit të

8 çështjes së Mbrojtjes.

9 Sa i takon dokumenteve janë më pak se 1000 dokumente që i

10 kemi në listën e provave materiale të rishikuar. Mendoj që

11 janë 995 për të qenë i saktë. Por, natyrisht, ky numër

12 përfshin një numër të madh përkthimesh, pra, numri i

13 dokumenteve të vetme është më pak se kaq. Nga ato mendoj që

14 nuk janë më shumë se 20 që duhet të dorëzohen për dëshmitarët

15 sipas rregullës 154, pra, pjesa dërrmuese e tyre do jenë

16 mocione për prova jогоjore, përveç atyre që do të dorëzohen

17 përmes dëshmitarëve të Mbrojtjes së Thaçit.

18 Do ta bëjmë këtë në mënyrë të vazhdueshme dhe graduale që

19 të mos harxhojmë kohë në mënyrë të panevojshme. Kjo do të

20 bëhet në bazë të temës së caktuar, ndoshta pas ndarjes së

21 materialeve në listën e provave materiale që ne kemi dhënë dhe

22 do t'ju japim hollësi të mëtejshme, por sot nuk mund t'ju jap

23 hollësi të mëtejshme. Nuk i kemi marrë këto vendime në mënyrë

24 përfundimtare akoma.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ne do t'u përgjigjemi kërkesave
2 kur të bëhen mocionet për zgjatje të kohës apo numrit të
3 fjalëve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
5 për të shtuar Mbrojtja e Selimit?

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
8 nga Mbrojtja e Veselit?

9 Z. DIXON: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani dhe këtë
11 e kemi përmendur edhe më herët, sa i takon pranueshmërisë së
12 listave të provave materiale të propozuara të Mbrojtjes së
13 Thaçit dhe Mbrojtjes së Krasniqit, Trupi Gjykses dëshiron të
14 dijë nëse është bërë ndonjë diskutim *inter partes*, pra, mes
15 palëve me ZPS-në lidhur me këtë pikë siç është sugjeruar në
16 seancën e fundit. Dhe nëse jo, pse jo?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne kemi kontaktuar ZPS-në lidhur
18 me listën e provave materiale që është dorëzuar në korrik. Ata
19 janë përgjigjur se nuk ishin në gjendje të përgjigjeshin deri
20 sa ne nuk kemi dorëzuar listën e provave materiale të
21 rishikuara që është dorëzuar dje. Kjo është dorëzuar të
22 premtën. Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Krasniqi.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne nuk kemi bërë këto diskutime
25 akoma, por mund ta bëjmë këtë në momentin kur të dorëzohet

1 lista e rishikuar e provave materiale.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, mendoj
3 që do të merrni përgjigjet para se të bëni këto diskutime.

4 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, e kemi
6 tanimë këtë listë të provave materiale të rishikuara dhe
7 shpresoj që këto diskutime të jenë të frytshme.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Dhe, siç e përmendët më herët,
9 informacioni që marrim nga Prokuroria sa i takon provave
10 materiale nuk janë të debatueshme për pranim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

12 Trupi Gjykses rikujton se në seancën e fundit për ecurinë
13 e çështjes më datë 22 korrik, urdhëroi Mbrojtjen që të
14 sigurojë, të dorëzojë përkthimet e dokumenteve të listës së
15 provave materiale që ajo synon të përdorë pesë ditë përpara
16 paraqitjes së dëshmitarit. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se
17 në F03402, Mbrojtja e Krasniqit njoftoi se ata kishin shtuar
18 përkthimet anglisht të dokumenteve të nxjerra nga Mbrojtja ku
19 dokumenti origjinal është në një gjuhë tjetër dhe jo anglisht.

20 Trupi Gjykses dëshiron të konfirmojë Mbrojtjen e Thaçit
21 se janë siguruar, janë dorëzuar përkthimet në anglisht të të
22 gjitha dokumenteve që Mbrojtja synon të përdorë në çështjen e
23 tyre.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, do të konsultohem
25 pak.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, për dokumente që janë
3 dokumente tona në listën tonë të provave materiale ka
4 përkthime për të gjitha ato besoj. Dhe sapo më thanë që për
5 dokumentet që janë dokumentet e ZPS-së në listën tonë të
6 provave materiale mendoj që janë përkthimet e tyre dhe ne
7 duhet ta rikontrollojmë këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
9 bëhet kjo përpara paraqitjes së provave të tua?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
12 vëren se në parashtrimet F03403, Mbrojtja e Krasniqit njoftoi
13 se ata kanë identifikuar dhjetë materiale të renditura që nuk
14 kanë përkthim anglisht dhe që do të nxjerrë përkthimet e tyre
15 sa më shpejt që të jetë e mundur. Trupi Gjykses për rrjedhojë
16 dëshiron të konfirmojë me Mbrojtjen e Krasniqit nëse këto janë
17 të vetmet dokumente për të cilat mungojnë përkthimet në
18 anglisht?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, kërkoj ndjesë, numri pak më
20 ndryshe nga ai që kam dhënë në konferencën për ecurinë e
21 çështjes të mëparshme. I kemi marrë këto nga lista e provave
22 materiale pas urdhrit tuaj për të zvogëluar numrin e
23 dokumenteve në të.

24 Besoj se janë dhjetë dokumente në tërësi për të cilat
25 duhet të bëhen përkthimet. Dhe ne synojmë që t'i dorëzojmë

1 këto përkthime përpara datës 15, pra, fillimit të paraqitjes
2 së provave të Mbrojtjes.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë reagim
4 lidhur me këtë?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Thjesht për të qartësuar diçka
6 lidhur me parashtrimin e z. Misetic. Sa i takon asaj që do të
7 bëhet nga Mbrojtja përpara që paraqitja e provave të Mbrojtjes
8 të fillojë, a do të bëhet verifikimi i përkthimeve ekzistuese
9 apo do të bëhen përkthime që do të plotësohen?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të bëhen verifikime. Dhe pas
11 këtij verifikimi do varet sesa dokumente duhet të përkthehen.
12 Dhe po flasim për dokumente të ZPS-së. Nuk janë shumë
13 dokumente që duhet të përkthehen.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju nuk e dini
15 sesa dokumente të ZPS-së keni? Nuk them që duhet ta dini. Por
16 po ju pyes nuk e dini.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di sesa dokumente të ZPS-së
18 të papërkthyer kemi.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk pres që të jenë shumë
21 gjithsesi. Kemi shumë dokumente të ZPS-së në listën tonë apo
22 dokumente që janë nxjerrë nga ZPS-ja. Por nuk mendoj që janë
23 shumë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të ishte
25 mirë që kjo të bëhet përpara datës 15 shtator. Pra, në qoftë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen (Seancë e hapur)

Faqe 47

1 se merrni ndonjë përgjigje, sigurohuni që t'ia transmetoni
2 këtë ZPS-së që ata ta dinë edhe Trupit Gjykues natyrisht.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ta bëjmë këtë gjë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto ishin të
5 gjitha dispozitat sipas rregullës 119, i trajtuam këto. Për
6 disa prej tyre do të duhet urdhër, gjë që do ta bëjmë ndoshta
7 përmes një urdhri të përmbledhur, pra, të konsoliduar apo për
8 tema materiale të caktuara individuale në qoftë se është e
9 nevojshme. Por nuk doja që të kalonim këtë pa u dhënë
10 mundësinë të gjithëve për të shprehur qëndrimin e tyre lidhur
11 me këtë.

12 Do t'i jap fjalën ZPS-së tani.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar
14 lidhur me këtë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
16 Thaçit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Asgjë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
19 Veselit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Vetëm një çështje. Kalendari u
21 përmend për muajt pas seancës së parë dhe desha thjesht të
22 kuptoj se kur do të nxirret kalendari, pra, sepse sa më shpejt
23 që të bëhet aq më mirë është për sa i përket planifikimit të
24 punës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një kalendar

1 është publikuar në KOSMOS.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi qasje ne në këtë. Ne kemi
3 thjesht ato tre javë që janë nxjerrë në kalendarin publik.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkoj
5 ndjesë. Do ta bëjmë këtë gjë sot.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Ky është kalendari -- po flasim për
7 kalendarin pas shtatorit pra.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shkon deri,
9 pra, kalendari vazhdon deri në pushimin e Vitit të Ri, pra,
10 duke filluar nga 15 shtatori.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Siç u kërku
13 dhe siç e thashë, janë 35 seanca, ditë seancash nga tani deri
14 atëherë. Dhe do të bëjmë saktësisht në të njëjtën mënyrë siç
15 kemi bërë në rastin e paraqitjes së provave të ZPS-së, pra,
16 katër ditë seancë, një javë pushim, katër ditë të tjera, tre
17 javë pushim.

18 E kuptoj që ju nuk keni qasje në këtë kalendar.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Po, e kuptoj që do të na jepet qasje
20 në të.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
22 nga dikush tjetër?

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Asgjë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
25 Krasniqit?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
3 shumë. Ishte e dobishme. Shpresoj të ketë qenë e dobishme dhe
4 për juve e për të gjithë. Do të bëjmë më të mirën tonë për t'u
5 përgjigjur pyetjeve që kanë dalë nga kjo seancë përmes një
6 urdhri apo ndoshta përmes emailit në qoftë se bëhet fjalë
7 thjesht për një përgjigje për diçka që siç e ngritët ju, z.
8 Dixon. Dhe do t'ju japim kopje të kalendarit.

9 Pra, takohemi në 15 shtator. Dhe ju lutem bëni atë ë të
10 mirën që mundeni për të parabërë parashtimet e mocioneve në
11 pritje që keni në mendje të parashtroni paraprakisht në kohë
12 me qëllim që të merremi me to dhe që të mos pengojmë
13 zhvillimin e seancave në data e parashikuara.

14 Në qoftë se nuk ka diçka tjetër, seanca ndërpritet.

15 --- Seanca mbyllet në orën 11.15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25